

Ditari Natyrës

Nr. 49 Viti i pestë i botimit Qerëhor 2017

Në këtë numër do të gjeni:

- ...me këtë rast Ju kujtojmë se...
- E ardhmja e tyre është e ardhmja jonë
- 21 Maji, Dita Europiane e Rrjetit Natura 2000
- 22 Maji, Dita Ndërkombëtare e Biodiversitetit
- One Love Valbona Park
- Shoqatat mjedisore aktive ndaj projektit të propozuar për ndërtimin e një resorti në brëndësi të PK Divjakë-Karavasta
- Trajnim për procedurat e VNM/VSM / nga Qendra EDEN
- Monitorimi i procedurave të VNM nga komunitetet lokale / nga Milieukontakt
- Njoftime

... me këtë rast Ju kujtojmë se
13 vjet më parë ...

Krijohet Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri (INCA)

INCA është një organizatë jo-fitimprurëse (OJF) e themeluar në Qerëhor të vitit 2000 dhe e regjistruar si e tillë nga Gjykata e Tiranës në vitin 2004, me vendimin Nr.1087. INCA ka zyrën e saj qendrore në Tiranë, por

Vijon në faqe 2



Parku Kombëtar Lugina e Valbonës © Foto INCA

Vijon nga faqe 1 vepron në të gjithë territorin e Shqipërisë dhe më gjerë nëpërmjet partnerëve në nivel kombëtar dhe në rajon.

Zyra qëndrore e organizatës ndodhet në Tiranë në adresën: Rr. Islam Alla, Pall. IVEA, Kat. I. Zyra është e pajisur me rrëth 10 poste pune, një sallë mbledhjeje me kapacitet 30 vende dhe ka të gjitha pajisjet e nevojshme, si kompjutera, skaner, fotokopje etj.

Organizata drejtohet nga Presidenti, i cili përfaqëson edhe personin juridik, i zgjedhur nga Këshilli Administrativ, i përbërë nga 5 persona. Këshilli është përzgjedhur nga Asambleja e Përgjithshme, e cila merr edhe vendimet kryesore për organizatën. Këshilli gjithashtu zgjedh edhe Drejtoren Ekzekutiv, i cili është përgjegjës për zbatimin e çështjeve teknike. Kryetari i Këshillit është gjithashtu edhe President i organizatës.

Për të arritur objektivat e saj instituti ka vendosur një strukture teknike të brëndëshme me përberje:

- Ruajtja e natyrës & biodiversiteti;
- Zonat e mbrojtura & Database;
- Ekosistemet e ujërave të embla;
- Zona detare e bregdetare;
- Menaxhim i projekteve;
- Komunikimi dhe faqja e internetit;
- Zyra e financës dhe ekonomike;
- Administrimi dhe dokumentimi.

Struktura mbulon kryesisht pjesën e logistikës dhe mbështetjes, grumbullimin e të dhënave dhe dokumentacionin. Aktualisht INCA ka një staf prej 9 vetash që punojnë në zyrë, por nga ana tjetër organizata ka një grup eksertësh të jashtëm nga fusha të ndryshme që punojnë përgjithësisht në universitete dhe institucionë kërkimore. Në nivel kombëtar INCA ka një listë eksertësh dhe persona kontakti që mbështesin dhe lehtësojnë punën e saj nëpër rrëthe (rrëth 30 individë).

Që prej dhjetorit 2008 INCA është gjithashtu anëtare e Partneritetit Botëror të Ujit (GWP). Në tre vitet e fundit INCA drejton rrjetin e shoqatave për Mbrojtjen e Natyrës që përfshin për momentin 8 organizata që zhvillojnë aktivitetin në të gjithë vendin.

Nga Dhjetori 2009 INCA është anëtare e IUCN (Qëndres Ndërkombëtare për Mbrojtjen e Natyrës) dhe shërben si zyrë përfaqësimi për organizatën e WWF (Fondi Botëror për Jetën e

Egër) në Shqipëri, ku ka realizuar dhe vazhdon punon për disa projekte së bashku.

Fokusi INCA-s është mbrojtja e natyrës dhe ruajtja e biodiversitetit në Shqipëri. Me projekte dhe eksperțizën e saj INCA po kontribuon në përmirësimin e menaxhimit të zonave të mbrojtura, për të zgjeruar rrjetin e zonave të mbrojtura të vendit nëpërmjet një qaseje pjesëmarrëse, dhe për menaxhim të qëndrueshëm të ujtit të freskët, bregdetar dhe ekosistemet detare.

Njëherasi, INCA është e angazhuar për ndërtimin e kapaciteteve, edukimin në ruajtjen e biodiversitetit dhe zhvillimin e qëndrueshëm dhe lehtësimin e komunikimit mes palëve të interesuara...www.inca-al.org

... 15 vjet më parë ...

...shpallet Ligji nr. 8906, datë 06.06.2002 "Përzonat e mbrojtura".

Ligji ka për objekt shpalljen, ruajtjen, administrimin, menaxhimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të zonave të mbrojtura dhe të burimeve natyrore e biologjike të tyre; lehtësimin e kushteve për zhvillimin e turizmit mjedisor; për informimin dhe edukimin e publikut dhe përfitime ekonomike, të drejtëpërdrejta dhe të tërthorta, nga popullsia vendore, nga sektori publik dhe privat.

Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mbrojtje të veçantë të përbërësve të rëndësishëm të rezervave natyrore, të biodiversitetit dhe të natyrës, në tërësi, nëpërmjet krijimit të zonave të mbrojtura.

Zonat e mbrojtura krijohen për të siguruar ruajtjen dhe ripërtëritjen e habitateve natyrore, të llojeve, të rezervave dhe të peizazheve natyrore.

Njëherazi, ligji rregullon mbrojtjen të zonave të mbrojtura, nëpërmjet 6 kategorive, që zbatohen në territorin e Republikës së Shqipërisë. Kategorizimi i zonave, statusi dhe niveli i mbrojtjes për secilën zonë mbështetet në kriteret e Qendrës Botërore të Ruajtjes së Natyrës (IUCN).

Me Ligjin nr.9868, datë 04.02.2008 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8906, datë 06.06.2002 "Për zonat e mbrojtura", u përcaktuan qartasi kriteret për shpalljen e një territori zonë e mbrojtur; procesi i nënzonimit sipas rëndësise së habitateve dhe Vijon në faqe 3

Vijon nga faqe 2 të ekosistemeve që bëjnë pjesë në to dhe shkalla e ruajtjes së tyre; përcaktimi i zonave ku strehohen tipat e habitateve natyrore, me interes për komunitetin european dhe të habitateve të llojeve, me interes për këtë komunitet; shpalljen e zonave të veçanta të ruajtjejes, duke theksuar që këto zona janë pjesë e rrjetit ekologjik kombëtar dhe mund të përfshijnë edhe zona të mbrojtura brenda rrjetit përfaqësues të zonave të mbrojtura, si dhe ekosisteme, habitate e peizazhe jashtë këtij rrjeti.

Janë caktuar kriteret e vlerësimit të zonës për një tip të caktuar habitati natyrore, me interes për komunitetin european si dhe kriteret e vlerësimit të zonës për një lloj, me interes për këtë komunitet.

Një risi në ndryshimet e ligjit bazë të zonave të mbrojtura është edhe shpallja e Parqeve Natyrore Rajonale. Përveç zonave të mbrojtura, me karakter kombëtar, që përfshihen në rrjetin përfaqësues të zonave të mbrojtura, këshillat e qarqeve, për nevoja të komunitetit, mund të shpallin parqe natyrore rajonale mjedise, që janë pronë e tyre e që kanë vlera natyrore, të tillë si pyje, kullota, rezervuarë, ligatina etj....

... 11 vjet më parë ...

...me VKM nr.402, datë 21.06.2006, ekosistemi natyrore i Malit të Dajtit, shpallet "Park Kombëtar" me sipërfaqe të zgjeruar prej 29,384.18 ha...

... 5 vjet më parë ...

...me VKM nr.44, datë 09.06.2010, sipërfaqja prej 12,570.82 ha e Parkut Kombëtar Detar "Karaburun-Sazan" zgjelohet në 12,427.95 ha...

... 7 vjet më parë ...

...me VKM nr.519, datë 30.06.2010 miratohen "Procedurat e propozimit e të miratimit dhe rregullat e administrimit të Parqeve Natyrore Rajonale"...

... 6 vjet më parë ...

...me urdhër të ministrit të Mjedisit nr. 404, datë 09.06.2011, u miratua Plani i Menaxhimit për Parkun Kombëtar "Butrint", me sipërfaqe prej 9,424.4 ha.

Me urdhrin nr. 405, datë 09.06.2011, u miratua Plani i Menaxhimit për Rezervatin Natyror të Menaxhuar "Kune-Vain-Tale", me sipërfaqe 4,393.2 ha...

... 4 vjet më parë ...

...me VKM nr.489, datë 13.06.2013, në zbatim të detyrimeve të konventës Ramsar "Konventa e ligatinave të rëndësise ndërkombetare veçanërisht si habitat i shpendëve të ujës", territori prej 15,118.6 ha, i Prespës së Madhe dhe të Vogël, u shpall dhe u përfshi në listën e ligatinave ndërkombetare veçanërisht si habitat i shpendëve ujorë, i rregjistruar me nr.site 2151, datë 03.07.2013....

... 3 vjet më parë ...

...më datë 11.06.2014, Këshilli Koordinativ Ndërkombëtar (ICC) i Programit "Njeriu dhe Biosfera" të UNESCO ka miratuar nominimin e Rezervës Ndërkufitare të Biosferës Ohër-Prespa (RNBOP) në sessionin e 26, të mbajtur në Joenkoeping, Suedi. Rezerva e re Ndërkufitare e Biosferës Ohër-Prespë përfshin basenin e ligenit të Ohrit dhe basenin e të dy ligureve të Prespës, që lidhen me të. Sipërfaqja e rezervës në pjesën shqiptare e maqedonase të basenit të Ohrit dhe nën-baseneve të ligureve të Prespës, është 446,244.52 ha. Kjo rezervë biosfere mbështetet mbi tre shtylla si: Konservimi; Zhvillimi i qëndrueshëm; Shkenca, edukimi dhe ndërgjegjësimi (logjistika)....

AKZM me strukturat e saj të vartësisë, ka detyrë dhe duhet të jetë e kujdeshshme që të evidentojnë dhe të marrin masa për kremitimin me dinjitet të këtyre datave historike, duke hapur një faqe të re në punën e tyre, për njohjen dhe promovimin e zonave të mbrojtura, duke bashkëpunuar ngushtë me institucionet dhe shoqërinë civile.

INCA është e gatshëmë që të ndihmojë për promovimin e vlerave të natyrës e të biodiversitetit, në ngritjen e kapaciteteve për përmirësimin e menaxhimit të rrjetit të zonave të mbrojtura dhe në hartimin e historisë së zonave të mbrojtura të Shqipërisë.

E ardhmja e tyre është e ardhmja jone

10 Maj 2017 - Dita Botërore e Shpendëve Shtegtar

E ardhmja e tyre është e ardhmja jone "Një planet i shëndetshëm për shpendët shtegtarë dhe njerëzit"

Dita Botërore e Shpendëve Shtegtar ka filluar të festohet nga viti 2006 dhe ka si qëllim që të sjellë në vëmëndjen e popullatës dhe të shërbejë si një dëtie ndërgjegjësimi për mbrojtjen e shpendëve shtegtarë dhe habitatet e tyre.

Kjo dite organizohet nga Sekretariati i Konventës për Ruajtjen e Specieve Migruese të Kafshëve të Egra (Konventa e Bonit) dhe Marrëveshja për Ruajtjen e Shpendëve Ujor Shtegtar Afrikano-Euroaziatik, dy marrëveshje ndërkombëtare për mbrojtjen e jetës së egër që administrohen nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Mjedisin (UNEP).

Të gjitha aktivitetet e organzuara në kuadër të Dites Botërore të Shpendëve Shtegtarë janë të bashkuar nga një temë e përbashkët. Motoja e 2017 është "E ardhmja e tyre është e ardhmja jone", dhe hedh dritë mbi temën "Zhvillim të Qëndrueshëm për jetën e egër dhe njerëzit".

Dita Botërore e Shpendëve Shtegtarë 2017, do të nxjerrë në pah ndërvareseinë e njerëzve dhe natyrës, veçanërisht njerëzit dhe shpendët migratorë, si ata ndajnë të njëjtin planet dhe kështu, të njëjtat burime natyrore të kufizuara. Fushata 2017 synon rritjen e ndërgjegjësimit për nevojën e një menaxhimi të qëndrueshëm të burimeve tona natyrore, duke demonstruar se ruajtja e shpendëve është e rëndësishme përtë ardhmen e njerëzimit.



21 Maji, Dita Europiane e Rrjetit Natura 2000

21 Maji është Dita Europiane e Rrjetit Natura 2000

Me festimin e kësaj Dite, synohet që të gjithë qytetarët evropianë të zbulojnë pasurinë mahnitëse të natyrës, ku ajo dhe njerëzit shkojnë dorë për dore si dhe kërkohet që Ditën

Europiane të Rrjetit Natura 2000 të kthehet në ditën në të cilën të gjithë ne do të bëjmë një gjest të mirë (simbolik apo real) përvendet tona natyrore.

Nën këtë premisë, qëllimi është që çdo person, organizatë ose institucion të bëjë një gjest të vetëdijes shoqërore në favor të ruajtjes së ekosistemit natyror dhe zogjve që banojnë në të. Është vendosur pikërisht 21 Maji sepse në 21 maj 1992 u miratua Direktiva e Habitave. Kjo direktive dhe Direktiva e Zogjve (miratuar në vitin 1979) janë baza e Rrjetit Natura 2000 dhe lejojnë mbrojtjen e zonave të Natura 2000. Që në vitin 2010 INCA në bashkëpunim të ngushtë me WWF për Meedheun (WWF MedPO) ka mbështetur procesin e Natura2000 në Shqipëri nëpërmjet projektit "Mbrojtja e biodiversitetit - fuqizimi i rolit të OJF-ve për promovimin e Rrjetit Natura 2000". Projekti ka patur si objektiv kryesor nxitjen e rolit dhe ngritjen e një rrjeti për organizatat të shoqerise civile në të gjithë vendin per vendosjen e rrjetit Natura 2000.



22 Maji, Dita Ndërkombëtare e Biodiversitetit

Biodiversiteti dhe Turizmi i Qëndrueshëm
 Kjo temë është zgjedhur për të përkuar me
 rastin e vittit 2017 si Viti Ndërkombëtar i
 Turizmit të Qëndrueshëm për Zhvillim së është
 shpallur nga Asambleja e Përgjithshme e
 Kombeve të Bashkuara në Rezolutën 70/193,
 të cilën e udheheq Organizata Botërore e
 Turizmit e Kombeve të Bashkuara.

Kombet e Bashkuara e
 shpallen 22 Majin
 si Ditën
 Ndërkombëtare
 të Biodiversitetit
 për të rritur
 ndërgjegjësimin
 dhe përmirësuar
 vlerësimin e
 çështjeve të
 biodiversitetit.
 Fillimi i shpallimit, në fund
 të vitit 1993,
 Komiteti i Dytë i
 Asamblesë së
 Përgjithshme të
 Kombeve të
 Bashkuara shpalli
 si Ditë
 Ndërkombëtare
 të Biodiversitetit

29 Dhjetorin, ditën e hyrjes në fuqi të
 Konventës së Biodiversitetit. Por në Dhjetor
 2000, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të
 Bashkuara shpalli 22 Majin si Dita
 Ndërkombëtare e Biodiversitetit, për të kujtuar
 miratimin e tekstit të konventës në 22 Maj
 1992 nga Akti Final i Konferencës së Nairobiit
 për Miratimin e tekstit të Konventës së
 Biodiversitetit.

Biodiversiteti, per sa i perket llojeve dhe
 ekosistemeve, ofron një bazë të rëndësishme
 për shumë aspekte të turizmit. Njohja e
 rëndësise së tij të madhe për ekonominë e
 turizmit dhe të peizazheve të rëndësishme, si dhe të
 biodiversitetit të pasur, mbështet çështjen e
 ruajtjes së biodiversitetit si në aspektin politik,
 edhe në atë ekonomik. Shumë çështje të
 adresuara sipas Konventës për Diversitetin
 Biologjik ndikojnë drejt përdrejt në sektorin e

turizmit. Një sektor turistik i mirë-menaxhuar
 mund të kontribuojë ndjeshëm në reduktimin e
 kërcënimeve, ruajtjes ose rritjes së populisë
 kryesore të kafshëve të egra dhe vlerave të
 biodiversitetit përmes të ardhurave nga turizmi.
 Turizmi lidhet me mjaft prej 20 targeteve të
 Biodiversitetit. Për disa objektiva kjo ka të bëjë
 kryesishët me sigurimin e kontrollit dhe
 menaxhimit më
 të madh për të
 zvogëluar
 dëmtimin e
 biodiversitetit
 nga turizmi. Për
 të tjerët, ka të
 bëjë me ndjekjene
 kontributit
 pozitiv të
 turizmit ndaj
 vetëdijes së
 biodiversitetit,
 zonave të
 mbrojtura,
 restaurimit të
 habitateve,
 angazhimit të
 komunitetit dhe
 mobilizimit të
 resurseve. Një
 dimision tjetër

është integrimi më i mirë i biodiversitetit dhe
 qëndrueshmërisë në politikat dhe modelet e
 biznesit të zhvillimit që përfshijnë turizmin.
 Festimi i Ditës Ndërkombëtare të Diversitetit
 Biologjik në këtë temë ofron një mundësi për të
 rritur ndërgjegjësimin dhe veprimin ndaj
 kontributit të rëndësishëm të turizmit të
 qëndrueshëm si për rritjen ekonomike, ashtu
 edhe për ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm
 të biodiversitetit. Për më tepër, tema ofron
 gjithash tu një mundësi unike përtë kontribuar në
 iniciativat e vazhdueshme të tilla si Programi i
 Turizmit të Qëndrueshëm të Kornizës 10-
 vjeçare të Programeve për Konsumin e
 Qëndrueshëm dhe Modelet e Prodhimit dhe për
 të promovuar Udhëzimet e CBD mbi
 Biodiversitetin dhe Zhvillimin e Turizmit.



22 MAY 2017 INTERNATIONAL DAY FOR BIOLOGICAL DIVERSITY

Biodiversity and Sustainable Tourism

One Love Valbona Park

Parku Kombëtar Lugina e Valbonës - 24 maj 2017 - Dita Evropiane e Parqeve Festohet edhe në Pakrun Kombëtar Lugina e Valbonës!

Parku Kombëtar Lugina e Valbonës, mirëpret fëmijët nga shkollat 9-vjeçare të qytetit të bajram Currit, të cilët i bashkohen parkut me mesazhin "One Love Valbona Park".

Si në të gjithë Evropën, Dita Evropiane e Parqeve u festua edhe në Shqipëri, për të përkujtuar krijimin e Parkut të Parë në Suedi, por njëkohësisht për të rritur ndërgjegjësimin publik mbi rëndësinë që kanë parqet në ruajtjen e

biodiverzitetit dhe zbutjen e ndikimeve klimatike.

Në Parkun Kombëtar Lugina e Valbonës, INCA së bashku me AdRZM Kukës, këtë ditë zgjodhën ta festojnë si një orë edukimi në natyrë për monitorimin e biodiversitetit dhe ekosistemeve natyrore, me nxënës të shkollës 9-vjeçare, me qëllim ndërgjegjësimin e brezit të ri dhe forcimin e lidhjes së tyre me natyrën.


Gjatë aktivitetit fëmijët u mblodhën në qendrën e Parkut dhe si fillim u njohën me vlerat e parkut, biodiverzitetin e tij, kafshët dhe bimët të cilat janë krenaria e parkut dhe e alpeve. Një kohe e veçantë ju kushtua rolit të administratës në mbrojtjen dhe promovimin e parkut dhe habitatit

natyror të pyllit. Më pas nxënësit u ndanë në dy grupe monitorimi. Një grup vëzhgoi pemët dhe tjetri zogjtë dhe kafshët e egra. Së bashku me rojet e parkut, fëmijët vëzhguan disa nga pemët me karakteristika të parkut dhe për më tepër, ata patën mundësi të punojnë në mënyrë specifike në karakteristikat e pemës si lartësia, diametri, perimetri dhe lloji, duke përdorur edhe disa nga mjetet e rojeve mjedisore. Grupi tjetër, i cili u angazhua me vëzhgimin e shpendëve u fokusua tek monitorimi i zërave të tyre dhe vëzhgimit nëpërmjet dylbive.

Në fund të aktivitetit, studentët vendosën në degët pemëve ushqim shpendësh të përgatitura me fara nga INCA.

Ky aktivitet ishte i rëndësishëm për brezin e ri për të inkurajuar kureshtjen dhe pasionin e tyre për ruajtjen e natyrës, përti përgatitur atë për të qenë "rojtarët e ardhshëm" të Parkut Kombëtar të Luginës së Valbonës.

Ky aktivitet u zhvillua në kuadër të projektit "Fuqizimi i OMSHC-ve shqiptare për promovimin e ruajtjes së natyrës në Shqipëri", i finansuar nga Bashkimi Evropian (Delegacioni në Shqipëri), në kuadër të programit ACHIEVE, i cili është zbatuar nga REC-Shqipëri.





Shoqatat mjedisore aktive ndaj projektit të propozuar për ndërtimin e një resorti në brëndësi të PK Divjakë-Karavasta

Para dy muajsh është kërkuar nga ana e kompanisë Mabetex Group të zhvillohet një dëgjesë publike përtérheqjen e opinionit nga ana e grupeve të interesit mbi zhvillimin e procedurës së Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM) për projektin që kjo kompani kërkon të zhvillojë si Master Plani "Resort Divjakë Albania" në zonën e Parkut Kombëtar Divjakë-Karavasta. Ky projekt nuk është asnjë tjeter veçse një projekt i ri ndërtimi në një Zonë të Mbrojtur që kërkon të përfitojë privatish nga një pasuri kombëtare e ruajtur prej shekujsh dhe sanksionuar në disa akte ligjore mbrojtëse që e kanë zanafilën që prej vitit 1964.



Projekti i ndërtimit kërkon zënien dhe zhdukjen e 10% të territorit të Parkut ndërkokë që infrastruktura shoqëruese e përbërë nga rrugë, ndriçim, rrjet elektrik, dallgëthyese dhe aktivitete të tjera do të ndikojë negativisht në 100% të sipërfaqes së tij. Për një vlerë vetëm 1 Euro, projekti kërkon të zaptojë 12 km të vijës bregdetare, të ndërtojë 2,400 apartamente, 370 vila, një resort turistik prej 90 ha dhe një qytet për 18,000 banorë. Ky kompleks i ri urban është për nga popullsia sa dyfishi i qytetit të Divjakës ndërkokë që ka një shtrirje dhe ndikim shumë më të gjërë në territor.

Procedura e ndjekur deri më tanë nga institucionet e shtetit dhe investitorët për paraqitjen e projektit para publikut është e kundraligjshme dhe përpigjet të fshihë karakterin shkatërrues të këtij projekti që do të sjellë jo vetëm dëmtim të ekosistemit,

habitave përbërës dhe gjallesave të egra, por edhe shkatërrim të ekonomisë lokale e sidomos asaj të peshkimit.

INCA, EDEN dhe Milieukontakt janë tashmë pjesë e grupimit të aleancës së OJF-ve të formuar me organizata lokale dhe ndërkombëtare aktive në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe ruajtjes së natyrës, për të kundërshtruar këtë zhvillim. Aleanca ha kërkuar urgjentisht nga Ministria e Mjedisit dhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes të mos e marrin në konsideratë këtë zhvillim, i cili do të shkatërrojë Parkun Kombëtar dhe burimet e vlefshme natyrore. Grupimi i shoqatave mjedisore ka nxitur gjithashtu të mbështhesë nismën edhe zyrën e Konventës së Bernës, IUCN, WWF nëpërmjet dërgimit tek ata të kërkesës për mbështetje duke i prezantuar propozimin dhe rreziqet që zbatimi i këtij projekti do të sjellë për zonën dhe natyrën e saj.



Trajnim për procedurat e VNM/VSM

Vazhdimi i flitet për rëndësinë që ka zhvillimi i projekteve të qëndrueshme të cilat i vijnë në ndihmë qytetarit dhe ndikojnë sa më pak në mjedisin ku ne ndodhemi. Ka një bazë ligjore dhe ka institucionale në vend të cilat përcaktojnë rolin që ka qytetari apo institacioni për një pjesëmarrje sa më transparente në proceset vendimmarrëse, megjithatë shihet nevoja e një shpërndarje më të mirë informacioni apo njohje më të mirë si të bazës ligjore, të institucioneve kompetente dhe të rolit të secilit aktor kyç. Për të ardhur në ndihmë kësaj çështjeje në qytetet zbatuese të projektit "Shoqëri pjesëmarrëse në vendimmarrje", vijonë trajnimet me titull "Procedurat e VNM/VSM: bazat ligjore dhe roli i pjesëmarrjes së publikut".



Ky trajnim është zhvilluar në Vlorë nga Qendra për Kërkim, Bashkëpunim dhe Zhvillim - CRCD" (9 mars 2017), në Berat "Për Mirëqenje Sociale dhe Mjedisore PMSSM" (16 mars 2017), për të vijuar në Shkodër "Qendra e Informacionit Aarhus - AIC Shkodër" (11 Prill); Elbasan "Klubi Ekologjik Elbasan -KEE" (18 Prill). Në këto trajnime kishte përfaqësues që ishin studentë, përfaqësues të Komunës, të Inspektoratit të Mjedisit, të institutit të shëndetit publik, të Agjencive Mjedisore rajonale, të administratës së Zonave të Mbrojtura, OJF, media, ekspertët e mjedisit, mësues dhe me tu përmbyllur trajnimi i fundit u zhvillua në Tiranë në 4 maj 2017 organizuar nga Qendra Mjedisore EDEN.

Ky trajnim që shërben për të rritur të kuptuarit të dokumentacionit të VNM/VSM, bazën ligjore dhe për të ndikuar në rritjen e ndërgjegjësimit për informim dhe pjesëmarrje në proceset

vendimmarrëse, mbodhi **nga Qendra EDEN**
 në Tiranë (4 maj 2017)

rreth 40 pjesëmarrës; studentë të degëve Biologji drejtimi mjedis, Inxhinierë mjedis, punonjës të lirë etj. Ekspertiza ne trajnimin e organizuar në Tiranë u dha nga Enio Haxhimhalli, Ekspert ligjor në sektorin e mjedisit dhe Alminda Memi, Drejtoreshë Ekzekutive Qendra e Informacionit Aarhus, Shkodër.

Trajnim i një ditor kishte një kombinim të pjesës teorike dhe të rasteve më konkrete, pjesë e cila në trajnim kishte më shumë interes dhe diskutime. Pjesëmarrësit zhvilluan dhe sesione praktike të komentimit të raporteve të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, si dhe identifikimin konkret të rasteve të cilat kërkojnë një vlerësim strategjik në mjedis apo vlerësim të ndikimit në mjedis. Trajnuesit shpjeguan dallimet kryesore të proceseve dhe rëndësinë e zhvillimit të njërit në krahasim më tjetrin në varësi të investimit konkret.

Përshtypje të pjesëmarrësve Z. Murat Lushka - "Trajnim i nga vlerësimi im ishte shumë i mirë sepse na angazhoi ne, të cilët jemi të diplomuar për inxhinieri mjedis i fushën ku kemi studiuar. Ky trajnim dhe të tjerët në vazhdim besoj do të na fasin në një linjë mësimesh mbi mjedisin dhe ekuipiencia personale të cilat do të na ndihmojnë në të ardhmen. Shpresoj të kemi sa më shumë trajnime të tillë, gjithashtu dhe pjesëmarrje në projektet që ju mund të organizoni".



Diskutimi u shoqërua me raste konkrete dhe më të njohura nga publiku, si ndërtimi i hidrocentraleve në Valbonë, në

Vijon nga faqe 9

Vjosë, kompleksit turistik në Divjakë etj.

Pjesëmarrja dhe interes i lartë për këtë trajnim tregon nevojën e zhvillimit të trajnimeve të tillë sa më të shpeshta dhe të nevojës së shkëmbimit të informacionit dhe ideve.

Fotografitë e trajnimit i ndiqni në facebook të Qendrës EDEN: https://www.facebook.com/pg/Qendra-EDEN-EDEN-Center-319334287560/photos/?tab=album&album_id=1015487702839756

1

Nëse doni të ndiqni zhvillimin e këtij trajnimi dhe në qytetet të tjera mund të ndiqni linjet e mbulimit mediatik:

Qendra për Kërkim, Bashkëpunim dhe Zhvillim (CRCD), Vlorë: <http://vloranews.net/procedurat-e-vnmvem-bazat-ligjore-dhe-roli-i-pjesemarrjes-e-publikut-ne-vendimarrje/>

Për mirëqenie sociale dhe Mjedisore, Berat, TV Globe- <https://www.youtube.com/watch?v=n2ho3hXrzFE&feature=youtu.be>

Monitorimi i procedurave të VNM nga komunitetet lokale

Ditën e enjte datë 25 maj ora 11:00

Milieukontakt së bashku me organizatat dhe autoritetet lokale organizuan një vizitë në një nga karrierat gurore që operojnë në fshatin

Picrragë në Njësinë Administrative Borizanë, Bashkia Krujë. Qëllimi i kësaj vizite ishte informimi i palëve të interesuara mbi këtë investim dhe ngritja çështjeve te cilat duhet të trajtohen në raportin e vlerësimit të ndikimit në mjedis.

Në takim ishin të pranishëm rrëth 15 persona përfaqësues të ARM Durrës, përfaqësues të firmës e cila do bëjë punimet, eksperete të studios që ka bërë raportin

Qendra e Informacionit Aarhus, Shkodër: TV1 Channel: <https://www.facebook.com/tv1channel.tv/videos/vb.197455842964/10154533980457965/?type=2&theater>

Klubi Ekologjik Elbasan: Elbasan TV <https://www.youtube.com/watch?v=B3ISW1PpmnE>

Projektit "Shoqëri pjesëmarrëse në vendimmarrje" drejtuar nga qendra mjedisore EDEN, zbatohet në pesë qytete të Shqipërisë në sajë të bashkëpunimit me organizatat lokale: Klubi Ekologjik Elbasan-KEE (Elbasan), Qendra e Informacionit Aarhus - AIC (Shkodër), Qendra për Kërkim Bashkëpunim dhe Zhvillim - CRCD (Vlorë), Për Mirëqenie Sociale dhe Mjedisore - PMSM (Berat). Ky projekt po zbatohet përmes Programit të Grantit të CO-SEED Shoqëria Civile Vepron për Zhvillimin Socio-Ekonomik mbi Bazat e një Mjedisit të Shëndetshëm. Ky projekt është financuar nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri (INCA)

nga Milieukontakt Shqipëri

e VNM-së, përfaqësues nga Klubi Ekologjik Krujë, Milieukontakt dhe banorë të zonës.

Karriera zinte një sipërfaqe shfrytëzimi 0.143 km² me kapacitet 100000 m³ në vit. Leja e shfrytëzimit ishte dhënë në vitin 2008 dhe në mungesë të shfrytëzimit, subjekti po i nënshtrohej

V N M
paraprake.

Dise nga diskutimet dhe shqetësimet e ngritura nga ekspertët mjedisore dhe komuniteti kishin lidhje me burimet ujore të zonës, rrugën këmbësore e cila përdoret nga fehtarët



Vijon në faqe 11

Faqe 10

Vijon nga faza 10

për tu lidhur me rrugën kryesore, mbi nivelin e zhurmave dhe mënyrën se si do të rehabilitohet zona pas përfundimit të punimeve. Në zonën e zbatimit të këtij projekti kalon lumi i Drogës i cili është shumë pranë sipërfaqes të dhënë në lejen e shfrytëzimit.


Sipas raportit të VNM-së thuhet se nuk do të ketë ndikime në ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore. Aktiviteti nuk do të ketë shkarkime në ujërat e zonës dhe nuk do të përdor ujin në proceset e punës dhe nuk pritet që të ketë dëmtime të ujérave. Megjithatë duke diskutuar mbi teknologjinë që do të përdoret ishte e qartë që patjetër firma XYZ do të përdorte ujin e lumit (me pompim) për grimcimin e gurit.

Ndaj një pjesë shumë e rëndësishme e punës së organave përgjegjëse dhe komuniteteve lokale duhet të jetë dhe monitorimi i subjektit gjatë punimeve. Karrierat gurore kanë ndikime negative në mjedis të cilat

gjatë zbatimit të projektit janë në nivele të konsiderueshme duke përmendur këtu dëmtimin e sipërfaqeve pyjore dhe peizazhin e zonës, ndotjen ose dëmtimin e ujérave sipërfaqësor ose nëntokësor, krijimin e zhurmave dhe pluhurave gjatë punës etj.

Më poshtë janë listuar disa nga masat që subjekti duhet të marri për zbutjen e ndikimeve në mjedis të cilat janë të përmendura dhe në rapport

- Lagia e shesheve gjatë punimeve dhe larja e automjeteve para daljes nga kantieri
- Të sistemojen dhe rehabilitohen të gjitha skarpatet dhe të kryhen punime mbrojtëse nga erozioni dhe efekti gjerryes
- Të respektohen 100% masat e përcaktuara në



projektin e rehabilitimit të sipërfaqeve mjedisore të dëmtuara

- Automjetet e transportit të qarkullojnë me shpejtësi të ulët në zonat e banuara dhe në rrugët e paafshatuar
- Para prerjes së pemëve pyjore të largohen nëpërmjet zhurmave të gjitha gjallesat e botës shtazore të këtij habitati
- Të mos kryhet asnjë shkarkim në mjediset ujore të zonës
- Të mos krijohet shqetësimë në qarkullim dhe tek banorët e zonës në asnjë rast
- Të zbatohen me rigorozitet kushtet teknike të punës në kantier

Ndikimet në mjedis do janë afatgjata pasi dhe

vë të rehabilitimi i mjedisit kërkon kohe të gjatë. Kjo është e lidhur me ecurinë e punimeve rehabilituese të cilat duhen të zhvillohen paralelisht me punimet ndërvite. Pas përfundimit të punimeve subjekti ka për detyrim rehabilitimin e komplotit

sipërfaqes të dëmtuar duke i shndërruar ato në mjedisë dhe peizazhe në përpunëje me natyrën. Milieukontakt do të vazhdojë të monitorojë dhe të jetë pjesë e proceseve të VNM-së dhe dëgjesave me publikun për të siguruar më shumë transparencë dhe përfshirje të komunitetit në mbrojtje të mjedisit.

Ky aktivitet organizohet në kuadër të projektit: "OSHC-të praktikojnë VNM-në në të gjitha fazat", mbështetur finanziarisht nga Projekti "Shoqëria Civile Yerpon për Zhvillimin Social-Ekonomik mbi Bazat e një Mjedisit të Shëndetshëm" (CO-SEED) me fonde të Bashkimit Evropian dhe që zbatohet nga Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri (INCA).

One Love Valbona Park

European Day of Parks also celebrated in Valbona Valley National Park!

Valbona Valley National Park welcomes children from the 9-year schools of the city of Bajram Curri, who joined the park with the message "One Love Valbona Park".

Like all around Europe, the European Day of Parks was also celebrated in Albania to commemorate the creation of the First Park in Sweden, and, at the same time, to raise public awareness regarding the importance of parks in biodiversity conservation and mitigation of climate impacts.

Together with AdRZM Kukës, INCA chose to celebrate as an outdoor education lesson in Valbona Valley National Park with school pupils, for monitoring biodiversity and natural ecosystems in order to raise awareness of the younger generation and strengthen their connection with mother nature.

During the activity, the children became acquainted with the park's values, its biodiversity, animals and plants, that have been considered as pride of the park and the alps.

A special time was devoted to the administration's role in the protection and

promotion of the park and the natural forest habitat. The students were divided into two monitoring groups. One group observed the trees and the other birds and wild animals. Along with the park guards, the children observed some of the park's characteristic trees. They had the opportunity to work specifically on tree characteristics such as height, diameter, perimeter and type, using some of the guards environmental tools. The other group, engaged in bird observation with binoculars, and focused also on monitoring their voices. At the end of the event, students distributed on tree branches bird food and seed prepared by INCA.

This activity encouraged youngster's curiosity and passion for nature conservation and gave them first lessons to become "future guards" of the Valbona Valley National Park

This activity was carried out within the framework of the project "Strengthening Albanian OMSHCs for Promotion of Nature Conservation in Albania" funded by the European Union (Delegation in Albania), within the ACHIEVE program, which was implemented by REC Albania.

Environmental associations active on the proposed project for building a resort within the Divjaka-Kravasta National Park

Two months ago, the Mabetex Group Company asked to hold a public hearing on stakeholder engagement on the development of the Strategic Environmental Assessment (SEA) procedure for the project that the company wants to develop as a Master Plan "Resort Divjakë Albania" in the area of the Divjakë-Karavasta National Park. This project is nothing but a new construction project inside the Protected Area that seeks to profit privately from a centuries-old national asset and sanctioned in several legal protection acts that originated since 1964.

The construction project requires the occupation and disappearance of 10% of the territory of the Park while the accompanying infrastructure consisting of roads, lighting, electric network, wave and other activities will adversely affect 100% of its surface. For a value of just 1 Euro, the project seeks to occupy 12 km of coastline, build 2,400 apartments, 370 villas,

a resort of 90 ha and a city for 18,000 people. This new urban complex is for the population of the city of Divjaka twice as it has a much wider coverage and influence on the territory.

The procedure so far pursued by state institutions and the investor for presenting the project to the public is illegal and attempts to conceal the devastating character of this project that will bring not only harm to the ecosystem, component habitats and wildlife, but also destruction of the local economy and especially of the fishery.

INCA, EDEN and Milieukontakt are already part of the alliance of NGOs formed with local and international organizations active in the field of environmental protection and nature conservation to counter this development. The Alliance has urgently asked the Ministry of Environment and the Ministry of Economic Development, Tourism, Trade and Entrepre- *continue on page 13*

continue from page 12

neurship not to consider this development, which will destroy the National Park and valuable natural resources. The association of environmental associations has also encouraged the initiative to support the Bern

Convention, IUCN, WWF office by sending them to the request for support by presenting the proposal and the risks that the implementation of this project will bring to its area and nature.

Training for EIA/SEA with CSOs

We are constantly talking about the importance of sustainable development of projects that help the living life of citizens and affect as little as possible the environment where we live in. There is a legal basis and there are institutions in the country that determine the role of citizen or institution for a transparent participation in decision-making processes, but there is a need for a better share of information or better knowledge of the fundamental related laws, Competent Institutions and the role of each key involved actor. To assist this issue, in the implementing cities of the project "Society participates in decision making", the trainings "EIA / SEA Procedures: Legal Basis and Role of Public Participation" is in ongoing. This training took place in Vlora by the Center for Research, Cooperation and Development - CRCD "(March 9, 2017), Berat" For Social Welfare and Environment FSWE "(March 16, 2017), to continue with Shkodra "Aarhus Information Center - AIC Shkodër" (April 11, 2017), Elbasan "Elbasan Ecological Club" (April 18, 2017). In these trainings were present students, representatives of the Municipality, the Environmental Inspectorate, the Institute of Public Health, the Regional Environmental Agency of Protected Areas, NGOs, Media, Environmental Experts, and Teachers etc. The last training was held in Tirana on May 4, 2017 organized by Environmental center for Development, Education and Networking (EDEN).

This training, which serves to increase the understanding of the EIA / SEA documentation, the legal basis and to influence awareness-raising for information and participation in decision-making processes, gathered around 40 participants in Tirana (4 May 2017): Students, environment engineers, free lances etc. The expertise in the training organized in Tirana was provided by Enio Haxhimihali, Legal Expert in the Environmental Sector and Alminda Mema, Executive Director of Aarhus Information Center, Shkodra.

The one day training source EDEN Center had a combination of theoretical and concrete parts and active discussion where very fruitful in the session of practical examples presented. Participants developed skills for commenting real report of EIA -Environmental Impact Assessment as well as identifying concrete examples which were subject to strategic environmental assessment or environmental impact assessment. The trainers explained the main differences of the processes and the importance of one's development in comparison to the other depending on the concrete investment.

Participants' impressions of the training: Mr. Murat Lushka - "The training from my evaluation was very good because it engaged us, that we are graduates of environmental engineering. This training and the others to come, I believe will put us in a good position of learning about the environment and developed the personal experience that will help us in the future. I hope to have as much training as this, as well as participate and being active in the projects that you organize" The discussion was followed will concrete cases that are based known in Albanian content, as Hydropower plant construction in Valbona, in Vjosë, Touristic Complex in Divjaka Park etc.

The participation and the great interest for this training topic demonstrate the need for developing of this training approach as more often as possible and show the need for exchanging of information of opinion and ideas.

Photos of the training can be followed on EDEN Facebook page: https://www.facebook.com/pg/Qendra-EDEN-EDEN-Center-319334287560/photos/?tab=album&album_id=1015487702839756_1

If you want to follow the development of this training in the other cities where it was organized you can follow the media coverage for its city:

Center for Research, Cooper-

continue on page 14

continue from page 13

tion and Development, CRCD -Vlorë: <http://vloranews.net/procedurat-e-vnmvesm-bazat-ligjore-dhe-rolli-i-pjesemarrjes-e-publikut-ne-vendimarrje/> For Social Welfare and Environment FSWE Berat, TV Globe - <https://www.youtube.com/watch?v=n2ho3hXrzFE&feature=youtu.be> Aarhus Information Center, Shkodra: TV1 Channel: <https://www.facebook.com/tv1channel.tv/vivid eos/vb.197455842964/10154533980457965/?type=2&theater> Ecological Club Elbasan: Elbasan TV <https://www.youtube.com/watch?v=B3IBW1PpmnE> The project "Society participates in decision

making" is implemented by EDEN Center in five cities of Albania in cooperation with local organizations: Ecological Club Elbasan (Elbasan), Aarhus Information Center - AIC (Shkodra), Center for Research, Cooperation and Development - CRCD (Vlora), For Social Welfare and Environment - FSWE (Berat). This project is being implemented through the CO-SEED Grant Program Civil Society Acting for Socio-Economic Development on the Basics of a Healthy Environment. This project was funded by the European Union and implemented from Institute for Nature Conservation in Albania (INCA).

Local communities monitor EIA procedures

source Milieukontakt Albania

On Thursday, 25 May at 11:00 Milieukontakt together with local organizations and authorities, organized a visit in a Career Exploitation of Limestone operating in the Picrraga village in Borizana Administrative Unit, Municipality of Kruja.

The purpose of this visit was to inform interested parties on this investment and come up with issues to be addressed in the environmental impact assessment report.

Present at the meeting were about 15 representatives from the Regional Environmental Agency of Durrës, experts of the studio that has made EIA report, representatives of Kruja Ecological Club, Milieukontakt, students of Environment Engineer and local inhabitants.

Careers Exploitation had an operating area of 0.143 km² with a capacity of 100,000 m³ per year. The Exploitation Permit was granted in 2008, but so far was not operational. The Company started the preliminary EIA.

Some of the discussions and issues raised by environmental experts and the community were related with water resources, road used by villagers to connect to the main road, noise level, and how the area will be rehabilitated at the end of the exploitation period. In the area passes the river of Droja, very close to the career.

In the EIA report, it is stated that there will be no impact on surface and underground waters. The activity will not have discharge into the waters of the area, will not use water in the process of the work thus it is not expected to have water damage. However, discussing on the tech-

nology to be used it was clear that the XYZ firm would use river water (with pumping) for stone crushing.

Monitoring of the subject during the works it is a very important part of the work of responsible environmental institutions and local communities.

Career Exploitation of Limestone have negative impacts on the environment, which during the implementation of the project are at significant levels, mentioning here the damage to the forest surfaces and the landscape of the area, the pollution or damage of surface or underground water, noise generation and dusting during work. Some of the measures that the entity will take to mitigate the environmental impacts mentioned in the study are:

- Squares washing during work and washing of vehicles before leaving the site;
- Arrange and rehabilitate all escarpments and carry out protective works from erosion and abrasive effect;
- Respect 100% of the measures set in the mitigation strategy for the damaged environmental surfaces;
- Vehicles run at low speed in residential areas and in rural road;
- Before cutting forest trees, all living creatures to be removed from their habitat through noises;
- Not to discharge into the waters of the area;
- Not to create disturbances

continue on page 15

continue from page 14

and traffic for residents in the area;

- Apply rigorously the Work Cautions at the site.

Environmental impacts will be in long-term because the environmental rehabilitation itself requires a long time. This is related to the progress of rehabilitation that should be developed in parallel with the works over the years. At the end of the exploitation period, the subject is obliged to rehabilitate the entire damaged area by transforming it into environment and land-

scape in accordance with nature.

Milieukontakt will continue to monitor and be part of EIA and public hearings to ensure more transparency and community involvement in environmental protection.

This activity is organized in the frame of the project: "CSOs practice EIA at all stages", financially supported by the project "Civil Society Acts for Environmentally Sound Socio-Economic Development" (CO-SEED) funded by European Union and implemented by Institute for Nature Conservation in Albania (INCA).

NJOFTIME

5 Qershor - Dita Botërore e Mjedisit

8 Qershor - Dita Botërore e Oqeaneve

15 Qershor - Dita Botërore e Erërave

17 Qershor - Dita Botërore e Luftës Kundër Shkretëtirëzimit dhe Thatësirës

21 Qershor - Dita e Liqenit të Ohrit / Dita e Liqenit të Shkodrës

1- Klaus Toepfer Fellowship - Klaus Töpfer Programme. Promoting excellence and leadership among emerging nature conservation leaders from Central and Eastern Europe, the Caucasus and Central Asia. <http://www.bfn.de/klaus-toepfer-fellowship.html>

2- Ftesë për pjesëmarrje në forumin "Investigimi i zbatimit në praktikë i legjislacionit për ruajtjen e natyrës në Shqipëri" <http://www.mjedisisot.info/index.php/njoftime/3285-ftese-per-pjesemarreje-ne-forumin-investigimi-i-zbatimit-ne-praktike-i-legjislacionit-per-ruajtjen-e-natyree-ne-shqiperi>

3- Përtë lexuar "Ditari i Natyrës" në vite...

<http://www.inca-al.org/index.php/eq/publikimet/ditari-i-natyres>

Udhëzime për të kontribuar në Ditarin e Natyrës

Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri mirëpret artikuj të ndryshëm të cilët ju dëshironi t'i publikoni në Ditarin e tij elektronik. Artikujt duhet të jenë jo më shumë se 200 - 250 fjalë. Ju lutemi të merrni në konsideratë këtë kërkesë, pasi intereseti për të shpërndarë artikuj, lajmë apo njoftime të ndryshme përmes Ditarit, mund të jetë i konsiderueshëm dhe ne do të përpigemi për të siguruar hapësirë për të qithë ju që dëshironi të kontribuoni. Redaksia ruan të drejtën për të shkurtuar apo modifikuar (jo tjetërsuar) tekstin nëse do të jetë e nevojshme.

Ju lutemi dërgoni një foto shoqëruese për artikullin tuaj dhe / ose web - link për referencë të mëtejshme.

Faleminderit për marrjen në konsideratë të këtyre udhëzimeve!

Grupimi "Të Shpëtojmë Arinjtë Shqiptarë"



Organizatat Partnere të Rrjetit për Mbrojtjen e Natyrës



Botim i Institutit për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri / INCA

Redakta: Nihat Dragoti; Ilijan Qirjazi; Vilma Kadu; Marinela Mitro